FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 144

Tiranë – E martë, 11 korrik 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 3.7.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 81, datë 16.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 644, datë 15.10.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2016-721, datë 28.4.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	6919
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 3.7.2017	Me objekt: - Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2911, datë 9.11.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. - Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 45, si dhe i shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".....	6925
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 3.7.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 00-2015-3553, datë 26.10.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 1289, datë 30.5.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	6930
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 48, datë 3.7.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 00-2016-710, datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 3880, datë 22.10.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 200, datë 2.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.....	6933
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 3.7.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 51, datë 28.4.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2016-656, datë 21.4.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	6938

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 3.7.2017

Me objekt: - Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë
- Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj
- Pagesa e pagës nga ana e Ministrisë së Brendshme deri në ekzekutimin e aktit të emërimit
- Interpretimi i nenit 8, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil"
- Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 6943

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 3.7.2017

Me objekt: - Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.
- Shpërblimi i dëmit për shkak të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm..... 6950

VENDIM
Nr. 45, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 16 Akti, që i përket:

KËRKUES: Levent Bregu

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 81, datë 16.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 644, datë 15.10.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2016-721, datë 28.4.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 30, 34, 42, 43, 131/1/f, 132, 134/1/i dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 7 dhe 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, mbi kallëzimin e shtetasit D. H., ka paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat çështjen kundër disa të pandehurve, midis të cilëve edhe kërkuesi Levent Bregu, akuzuar për veprat penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim, vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara përkatësisht nga nenet 78/2- 25, 76-25-22 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP).

2. Kërkuesi dhe bashkëtëpandehurit e tjerë janë akuzuar se në datën 3.8.1997 kanë vrarë me armë zjarri në banesën e saj shtetasen M. H., si dhe kanë tentuar të vrasin bashkëshortin e saj D. H. Në momentin që ka ndodhur ngjarja, nuk është bërë kallëzim. Në kallëzimin e datës 19.2.1998 të shtetasit D.H., ky i fundit ka deklaruar se nuk ka parë njeri, po ka dëgjuar vetëm të shtëna armësh. Prokuroria ka pezulluar procedimin në datën 17.4.1998 për moszbulim të autorit. Në datën 4.11.2002, kallëzuesi është riparaqitur në Prokurori duke deklaruar se ka parë të pandehurin R. B. të qëllonte në drejtim të tij. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se në vitin 1998 nuk ka deklaruar asnjë emër, sepse kishte frikë për fëmijët e tij, pasi në atë kohë nuk kishte shtet. Ndërsa në datën 16.1.2003, kallëzuesi ka deklaruar se së bashku me të pandehurin R. B. ka identifikuar kërkuesin dhe të pandehurin tjetër S. B.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 12, datë 28.1.2005, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/2-25 të KP-së; deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për veprën penale të vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76-26-22 të KP-së; deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 73, datë 16.2.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 28.1.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e njërit prej bashkëtëpandehurve të tjerë, me vendimin nr. 441, datë 30.9.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 73, datë 15.2.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 12, datë 28.1.2005, të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Berat, si dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me tjetër trup gjykues.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në rishqyrtimin e çështjes, me vendimin nr. 81, datë 16.3.2011, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/2-25 të KP-së dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 20 vjet burgim; deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76-26-22 të KP-së dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 10 vjet burgim; deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 20 vjet burgim.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 644, datë 15.10.2014, ka vendosur për kërkuesin lënien në fuqi të vendimit nr. 81, datë 16.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-721, datë 28.4.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

9. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, pasi ato i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

9.1. Është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'u dëgjuar.

9.2. Është cenuar neni 32/2 i Kushtetutës, sepse askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

9.3. Gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, sepse e ka filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer krimin për të cilin akuzohet pa u bazuar në prova.

9.4. Është cenuar parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, sepse gjykatat e faktit në rigjykimin e çështjes e kanë shpallur atë fajtor edhe pse vendimet e mëparshme që e deklaronin të pafajshëm nuk janë ankimuar nga prokurori.

9.5. Në rigjykimin e çështjes, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë deklaruar kërkuesin fajtor pa prova, duke u mbështetur në deklarimet e kallëzuesit dhe disa dëshmitarëve të tjerë, të cilat janë çmuar në mënyrë të gabuar dhe janë kontradiktore me njëra-tjetrën.

9.6. Është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

9.7. Gjykata e Lartë nuk i ka korrigjuar të metat e gjykatave të faktit lidhur me rëndimin e pozitës së kërkuesit.

10. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

10.1. Kërkuesi nuk legjitimohet në lidhje me cenimin e së drejtës së mbrojtjes, së drejtës për t'u dëgjuar, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi nuk i ka ngritur këto pretendime në rekurs.

10.2. Parimi i prezumimit të pafajësisë nuk është cenuar, sepse nuk rezulton asnjë e dhënë që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë shqyrtuar çështjen me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

10.3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit nuk e ka vendosur kërkuesin në ndonjë pozitë më të rëndë në raport me vendimin e Gjykatës së Apelit. Kur çështja është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për rigjykim, vendimi i apelit nuk mund të merrej si referencë, sepse ai rezultonte i prishur.

10.4. Kërkuesi nuk ka konkretizuar se ku konsistojnë shkeljet në procesin e Gjykatës së Lartë në vitin 2016.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda

afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se, edhe pse kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, si dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, këto pretendime nuk janë ngritur në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit nr. 644, datë 15.10.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe se, për më tepër, kërkuesi nuk ka konkretizuar se ku konsistojnë këto shkelje në rastin objekt shqyrtimi.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet asaj, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton se ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete *(shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese).* Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi *(shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Gjykata ka theksuar se neni 131/1/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore *(shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

15. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet në lidhje me pretendimet e lartpërmendura. Për pasojë, në vijim, Gjykata do të trajtojë ato pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin e saj në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e kërkesës

B.1. Për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit gjatë rigjykimit të çështjes

16. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë në rigjykimin e çështjes kanë rënduar pozitën e tij, pasi e kanë deklaruar fajtor edhe pse ndaj vendimit të pafajësisë të dhënë fillimisht ndaj tij nuk ishte ushtruar rekurs nga prokurori. Sipas kërkuesit, edhe Gjykata e Lartë nuk ka korrigjuar të metat e gjykatave të faktit.

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit nuk e ka vendosur kërkuesin në ndonjë pozitë më të rëndë në raport me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë të vitit 2007. Kur çështja është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për rigjykim, vendimi i apelit nuk mund të merrej si referencë, sepse ai rezultonte i prishur.

18. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius)* parashikohet në legjislacionin procedural penal dhe konkretisht në nenin 425, pika 3, të KPP-së. Sipas këtij neni, "*kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar*".

19. Gjykata është shprehur se parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është i lidhur me garancinë e aksesit në gjykatë si element i procesit të rregullt. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, por ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Gjykata është shprehur se ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe

të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 15, datë 22.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 2, datë 6.2.2009, në të cilin kërkuesi bazon edhe pretendimin e tij, janë shprehur se: "*ndreqja e gabimeve të lejuara nga gjykata e gjykimit të mëparshëm, gjatë rigjykimit të çështjes, kur vendimi prishet mbi ankimin vetëm të të gjykuarit (pavarësisht shkaqeve të prishjes), nuk duhet të rëndojë pozitën e tij. Në përforcim të këtij rregulli unifikues, këto Kolegje sjellin si argument edhe faktin e njohur që në procesin penal individi ndodhet përballë shtetit. Ai ndodhet përballë organit të akuzës, që, sikurse dihet, ka barrën e provës. Por edhe kur është para gjykatës që shqyrton akuzën e ngritur kundër tij, si dhe provat e sjella nga prokurori për të provuar këtë akuzë, mundësitë dhe mjetet që ka në dispozicion individi i akuzuar për të realizuar një mbrojtje efektive përballë tyre, jo rrallë ndodh që të mos jenë të ekuilibruara me ato të organit të akuzës, që përfaqëson shtetin*".

21. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Apelit Vlorë e kanë deklaruar kërkuesin të pafajshëm për veprat penale për të cilat është akuzuar. Vendimi nr. 73, datë 15.2.2007, i Gjykatës së Apelit Vlorë është ankimuar vetëm nga bashkipandehuri tjetër R. B. dhe jo nga Prokuroria. Gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, nga dosja gjyqësore rezulton se si në mendimin e paraqitur nga Prokuroria, ashtu edhe në seancën gjyqësore të datës 30.9.2009, prokurori ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe deklarimin fajtor të të gjithë të bashkëtëpandehurve (pra edhe të kërkuesit). Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 441, datë 30.9.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 73, datë 15.2.2007, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 12, datë 28.1.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me tjetër trup gjykues. Ajo ka arsyetuar se deklarimet e dëshmitarëve përshkruhen nga kontradikta të qenësishme për gjykimin e çështjes dhe se arsyetimi i gjykatave të faktit nuk ndjek një rrjedhë logjike, si dhe bazohet mbi dyshime të cilat në mjaft raste nuk mbështeten në prova ose mbështeten në prova kontradiktore, që bien ndesh me rrethanat e faktit.

22. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 81, datë 16.3.2011, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, duke çmuar përsëri provat mbi të cilat ajo ka mbështetur vendimin, e ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/2-25 të KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave ka vendosur dënimin e tij me 20 vjet burgim; fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76-26-22 të KP-së dhe në bazë të këtyre dispozitave ka vendosur dënimin e tij me 10 vjet burgim; fajtor për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe në bazë të kësaj dispozite ka vendosur dënimin e tij me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 20 vjet burgim.

23. Vendimi nr. 81, datë 16.3.2011, i lartpërmendur është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 644, datë 15.10.2014, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2016-721, datë 24.4.2016, pretendimit të kërkuesit për rëndimin e pozitës i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsyetim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij, pavarësisht se arsyetimi i vendimit (qoftë edhe me një argumentim të shkurtuar të pretendimeve) është detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës dhe KPP-ja.

24. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Po në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë

përgjigje shkaqeve të parashtruara në rekurs. Sipas Gjykatës, në të tilla raste kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ-ja. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal /procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkuesit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij *(shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 27, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

30. Bazuar në sa më lart, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, edhe pse gjatë gjykimit të parë, të paankimuar nga Prokuroria, kërkuesi është shpallur i pafajshëm dhe në rigjykim është deklaruar fajtor, nuk e ka shqyrtuar në themel pretendimin e kërkuesit lidhur me cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial në këndvështrim të së drejtës për të pasur një

vendim përfundimtar që do t'u jepte përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese.

B.2. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

31. Kërkuesi pretendon se gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, sepse e ka filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer krimin për të cilin akuzohet pa u bazuar në prova.

32. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, sepse nuk rezulton asnjë e dhënë që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë shqyrtuar çështjen me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

33. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilave është *in dubio pro reo,* pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i Konventës. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*). Në çështjen *Karaman kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime.

35. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla si aktet e ekspertimit, thëniet e dëshmitarëve etj., dhe se gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ato nuk kanë arritur në asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Për pasojë, Gjykata, nisur edhe nga ecuria e procesit në tërësinë e tij, vlerëson se nuk rezulton që gjykata ta ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

36. Ndërsa në lidhje me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim, në kuptim të parimit të barazisë së armëve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër *(shih vendimet nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 16, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural, si dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjykata ndërhyn vetëm në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

37. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

38. Si përfundim, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej t'u jepte përgjigje në themel pretendimeve të kërkuesit, në mënyrë të veçantë pretendimit për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës, duke realizuar në këtë mënyrë të drejtën e aksesit, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial nëpërmjet një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/1/f dhe nenit 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-721, datë 28.4.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM
Nr. 46, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 27 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Nevruze Dema

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2911, datë 9.11.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 45, si dhe i shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 17, 18, 33, 42, 44, 52, 131/1/f, 134/1/i dhe 142/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me shkresën e datës 18.4.2012 të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë, kërkueses Nevruze Dema, me detyrën e edukatores së konviktit, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të mbushjes së moshës së pensionit. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur t'i paguajë pagën e një viti punë për zgjidhjen e marrëdhënies së punës pa respektuar afatin e njoftimit, në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të pajustifikuara etj.

2. Me vendimin nr. 8111, datë 12.7.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar.

3. Me vendimin nr. 42, datë 16.1.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur moskompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

4. Me vendimin nr. 502, datë 5.3.2014, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8111, datë 12.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi, kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

5. Me vendimin nr. 00-2016-2911, datë 9.11.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të

paraqitur, për arsye se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*ligji nr. 49/2012*).

II

6. ***Kërkuesja Nevruze Dema*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

6.1. Në gjykatën e shkallës së parë nuk është zhvilluar hetim gjyqësor, nuk është lejuar debat midis palëve ndërgjyqëse dhe kërkuesja nuk është njohur me prapësimet e çështjes, si dhe me konkluzionet e specialistëve të gjykatës apo të ISSH-së. Në Gjykatën Administrative çështja nuk kaloi në seancë gjyqësore, pasi kjo qe paracaktuar në njoftimin e relatorit të çështjes. Hetimi gjyqësor dhe normat procedurale të shkelura në gjykatën e shkallës së parë dhe mosmarrja në shqyrtim nga gjykata e apelit tregojnë se çështja është shqyrtuar vetëm në një shkallë gjykimi, e paravendosur, e gjykuar me anshmëri, si dhe në kundërshtim me të drejtat ligjore dhe kushtetuese të kërkueses. Ligji nr. 49/2012 mosparaqitjen e palëve nuk e konsideron si pengesë për zhvillimin e gjykimit, por nuk përjashton as pjesëmarrjen në gjykim, aq më tepër që përfaqësuesi i kërkueses ka kërkuar të marrë pjesë në gjykim.

6.2. Në vendimet gjyqësore konkludohet se koha e daljes në pension përcaktohet nga punëdhënësi, ndërkohë që është e kundërta, pasi ai përcaktohet nga Kodi i Punës. Veç pushimit të padrejtë nga puna, pala e paditur nuk i ka paguar kërkueses sigurimet shoqërore, ndërkohë që i ka mbajtur nga rroga.

6.3. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është jokushtetues dhe është dhënë në shkelje të ligjit nr. 49/2012. Gjykimi në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë është bërë pa njoftim nga ana e Gjykatës, as në faqen zyrtare të saj, ndërkohë që vendimi për mospranimin e rekursit është njoftuar vetëm në faqen zyrtare të Gjykatës, 2 muaj pasi ishte dhënë ky vendim. Koha në të cilën është shqyrtuar rekursi është mbi 2 vjet, ndërkohë që afati i shqyrtimit në Gjykatën e Lartë është 90 ditë.

6.4. Shkronjat "c" dhe "ç" të neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 vijnë në kundërshtim me nenet 17 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe me nenet e tjera të këtij ligji. Ato nuk respektojnë parimin e barazisë para ligjit, duke vendosur kufizimin e së drejtës së ankimit në bazë të vlerës së aktit që kundërshtohet.

7. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë*****,** nuk ka paraqitur argumente me shkrim në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Gjykata vëren se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit. Edhe pse ndryshimet ligjore në ligjin organik të Gjykatës janë miratuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, sipas nenit 86 të këtij ligji, zbatimi i afateve të reja ligjore ka filluar në datën 1 mars 2017. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se ajo është paraqitur në Gjykatë në datën 27.2.2017, ndaj në rastin konkret afati i paraqitjes së saj do të llogaritet sipas rregullimeve të vjetra ligjore. Në këtë kuptim rezulton se vendimi më i fundit në kohë, i kundërshtuar nga kërkuesja, është ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i datës 9.11.2016, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

9. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/1/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në

varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kërkesë është pretenduar se në gjykatën e shkallës së parë nuk është zhvilluar hetim gjyqësor, nuk është lejuar debat midis palëve ndërgjyqëse, si dhe kërkuesja nuk është njohur me prapësimet e çështjes dhe me konkluzionet e specialistëve të gjykatës apo të ISSH-së. Po ashtu është pretenduar se në Gjykatën Administrative çështja nuk ka kaluar në seancë gjyqësore, pasi kjo qe paracaktuar në njoftimin e relatorit të çështjes. Gjykata vëren se këto pretendime të kërkueses nuk janë ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Gjykata e Lartë dhe kërkuesja nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat e zakonshme, në lidhje me këto pretendime, ajo nuk ka shteruar mjetet ligjore në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës, si një nga kriteret ligjore për paraqitjen e ankimit kushtetues në kuptim të nenit 71/a, pika 1/a të ligjit nr. 8577/2000.

10. Kërkuesja ka pretenduar gjithashtu edhe se gjykatat kanë keqzbatuar ligjin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipas saj, në vendimet gjyqësore konkludohet se çështja e daljes në pension përcaktohet nga punëdhënësi, ndërkohë që është e kundërta, pasi ai përcaktohet nga Kodi i Punës. Po ashtu, veç pushimit të padrejtë nga puna, kërkueses nuk i janë paguar as sigurimet shoqërore, edhe pse i janë mbajtur nga rroga. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkueses kanë natyrë ligjore për sa kohë kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga ana e tyre. Për sa kohë që kërkuesja nuk ka mundur t'i ngrejë këto pretendimeve në nivel kushtetues, ato nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

11. Kërkuesja ka kundërshtuar edhe disa dispozita të ligjit nr. 49/2012, duke pretenduar se ato bien ndesh me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës. Sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, kurse sipas nenit 134/2 të Kushtetutës individi, si një nga subjektet e parashikuara në pikën 1/i të këtij neni, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij. Gjykata vëren se shkronjat "c" dhe "ç" të neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, të kundërshtuara në kërkesë, parashikojnë kufizimin përkatësisht të së drejtës së ankimit dhe të së drejtës për të ushtruar rekurs në varësi të vlerës së aktit të kundërshtuar. Po ashtu, Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se kërkuesja ka ushtruar si të drejtën e ankimit, ashtu edhe të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ajo nuk provon interesin e saj të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e këtyre dispozitave ligjore, për sa kohë që ato nuk kanë sjellë asnjë pasojë për të. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk legjitimohet për kundërshtimin e neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012.

B. Për pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

12. Sipas kërkueses, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është jokushtetues dhe është dhënë në shkelje të ligjit nr. 49/2012. Gjykimi në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë është bërë pa njoftim nga ana e Gjykatës, as në faqen zyrtare të saj, ndërkohë që vendimi për mospranimin e rekursit është njoftuar vetëm në faqen zyrtare të Gjykatës, 2 muaj pasi ishte dhënë ky vendim. Kërkuesja pretendon edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, sepse koha në të cilën është shqyrtuar rekursi i saj është rreth 2 vjet e 8 muaj, ndërkohë që sipas dispozitave ligjore afati i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është 90 ditë.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se është në kompetencë të Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Kjo është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 45, datë 23.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese).* Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese).* Vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi nga ana e Gjykatës së Lartë dhe mospranimi i tij për shqyrtim në seancë gjyqësore nuk mjaftojnë për të konkluduar se procesi i zhvilluar në atë gjykatë është jo i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

14. Gjykata vëren se sipas nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Bazuar në informacionin e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se administrata gjyqësore ka proceduar me shpalljen e datës 18.10.2016 për njoftimin e seancave gjyqësore të datës 9.11.2016, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses, pra ka përmbushur detyrimin e saj ligjor. Kërkuesja, edhe pse ka barrën e provës në proces, nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur pretendimin e saj. Gjykata vlerëson se kërkuesja e ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Administrativ i asaj Gjykate, në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e çështjeve administrative në atë shkallë gjykimi, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, duke mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me to. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses në lidhje me njoftimet është i pabazuar.

15. Në lidhje me pretendimin për mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individi legjitimohet për të pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe në këtë drejtim, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e një pretendimi të tillë, Gjykata merr parasysh disa elemente, që janë rrethanat e çështjes konkrete, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjellja e kërkuesit, sjellja e autoriteteve, si dhe rreziku që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.

16. Në lidhje me periudhën që duhet marrë në konsideratë rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 27.6.2014 dhe është shqyrtuar në dhomën e këshillimit në datën 9.11.2016, datë në të cilën është dhënë edhe vendimi. Pra, kohëzgjatja e shqyrtimit të kësaj çështje nga Kolegji Administrativ është rreth 2 vjet e 4 muaj, edhe pse sipas nenit 60 të ligjit nr. 49/2012 Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar ai.

17. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, për rrjedhojë gjykimi i saj i nënshtrohet rregullave të ligjit nr. 49/2012. Objekt i padisë së paraqitur në gjykatë është detyrimi i subjektit të interesuar që t'i paguajë kërkueses pagën për shkak të zgjidhjes së

marrëdhënies së punës pa respektuar afatin e njoftimit. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj.

18. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

19. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Në këtë kuptim, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim) (*shih vendimin nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Po në këtë këndvështrim, Gjykata në çështje të ngjashme ka vlerësuar se justifikimet se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, për shkak se çështja nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, siç parashikohet edhe në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtar pjesërisht kundër: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 47, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 19 Akti, që i përket:

KËRKUES: Genci Murthi, Iris Murthi, Ines Sadikaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria e Sigurimeve “Atlantik” sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2015-3553, datë 26.10.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 1289, datë 30.5.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, Genci Murthi etj., që kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve “Atlantik” sh.a., që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet e çështjes rezulton se kërkuesit kanë qenë palë paditëse në procesin gjyqësor civil kundër subjektit të interesuar, me objekt: *“Detyrimin e të paditurit, shoqërisë së sigurimeve “Atlantic” sh.a., për të shpërblyer secilin paditës për dëmin shëndetësor pasuror dhe jopasuror që ata kanë pësuar nga aksidenti automobilistik i datës 16.11.2008”.*

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7864, datë 25.7.2012, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë së ngritur nga paditësit Genci Murthi, Iris Murthi dhe Ines Sadikaj, duke u detyruar i padituri, shoqëria e sigurimeve “Atlantic” sh.a., për t’u paguar atyre si dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror përkatësisht shumat respektive si vijojnë: paditësit Genci Murthi shumën prej 772.987 lekësh; paditëses Iris Murthi shumën prej 803.627 lekësh dhe paditëses Ines Sadikaj shumën prej 1.728.358 lekësh – dëm shëndetësor, pasuror dhe jopasuror ky që rezulton se këtyre paditësve u është shkaktuar nga aksidenti automobilistik i datës 16.11.2008. Rrëzimin për pjesën tjetër të mbetur të padisë së ngritur nga paditësit Genci Murthi, Iris Murthi dhe Ines Sadikaj (për kërkimin e dëmshpërblimit mbi kufirin e sipërcituar), si të pabazuar në prova e në ligj. Rrëzimin si të pabazuar në prova e në ligj të padisë së ngritur nga paditësja L. K.”.*

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1289, datë 30.5.2013, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 7864, datë 25.7.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2015-3553, datë 26.10.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

II

5. ***Kërkuesit*** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

5.1. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë dhe standardi i arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese që lidhen me burimet e së drejtës dhe fuqinë ligjore të një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Edhe Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar nga pikëpamja substanciale pretendimet e kërkuesve në lidhje me fuqinë ligjore të udhëzimit nr. 24, datë 15.11.2007, në raport me vendimin unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

5.2. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike,* pasi ngjarja e sigurimit ka ndodhur në vitin 2008 dhe ligji i zbatueshëm në çështjen konkrete është vendimi unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili për sa kohë ka interpretuar dispozitat e Kodit Civil i ka zëvendësuar ato në kuptim të përmbajtjes së tyre, dhe në bazë të nenit 145 të Kushtetutës ka epërsi mbi aktet me karakter nënligjor, siç është rasti konkret i udhëzimit nr. 24, datë 15.11.2007, "Për trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", i ministrit të Financave, mbi të cilin gjykatat kanë bazuar vendimet e tyre.

6. ***Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve "Atlantik" sh.a.***, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

*6.1. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazua*r. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë dhënë vendime të arsyetuara në lidhje me pretendimet e kërkuesve. Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, ka respektuar standardin e arsyetimit, duke analizuar pretendimet e ngritura në rekurs dhe duke u dhënë përgjigje atyre.

6.2. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Vendimi unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lejon dhe pranon vlerësimin e dëmit pasuror dhe jopasuror me parimet e ekonomisë së tregut vetëm në ato raste kur nuk ekzistojnë tarifa të përcaktuara me akte të tjera normative. Në rastin konkret nuk mund të zbatohen parimet e ekonomisë së tregut, sepse ekzistojnë norma dhe tarifa konkrete për vlerësimin e dëmit për këto raste e që parashikohen shprehimisht në udhëzimin nr. 24, datë 15.11.2007, "Për trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", të ministrit të Financave.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

7. Gjykata vëren se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe nisur nga ky parim sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor *(shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 05.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

9. Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në thelb ka të bëjë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit nga gjykatat. Duke qenë me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tij nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

10. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me

funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materia* në lidhje me këtë pretendim.

B. Për pretendimet e cenimit të së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit

12. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese që lidhen me burimet e së drejtës dhe fuqinë ligjore të një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Edhe Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar nga pikëpamja substanciale pretendimet e kërkuesve në lidhje me fuqinë ligjore të udhëzimit nr. 24, datë 15.11.2007, në raport me vendimin unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

13. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit përfshin jo vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës *(shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë në dhomë këshillimi, Gjykata ka theksuar se është detyrë e kolegjeve të asaj gjykate që mbi bazën e bindjes së brendshme të vlerësojnë nëse rekursi përmban shkaqe ligjore për shqyrtimin në seancë gjyqësore ose për mospranimin e rekursit. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues lidhur me natyrën ligjore të shkaqeve të paraqitura në rekurs është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon kjo gjykatë (*shih vendimin nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar. Atyre gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat e faktit u është dhënë mundësia që të paraqesin argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tyre, për të cilat kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat. Po ashtu, edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, u ka dhënë përgjigje kërkuesve lidhur me to, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Ata e kanë ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë nëpërmjet paraqitjes së rekursit, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Për pasojë, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar.

16. Për sa i përket arsyetimit të vendimit, Gjykata ka theksuar vazhdimisht faktin se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 09.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si pjesë e pandarë e një procesi të rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes,

analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 20, datë 20.3.2017; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh edhe natyrën e gjykimit në atë gjykatë, Gjykata ka theksuar se një arsyetim i kufizuar i tyre nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Vetëm kur konstatohen shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar prej saj, vendimi i Gjykatës së Lartë vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 48, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 31.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 18 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Zamira Abazi

SUBJEKT I INTERESUAR: Shkolla e mesme "Ndre Mjeda", Bushat, Shkodër

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2016-710, datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 3880, datë 22.10.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 200, datë 2.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Zamira Abazi, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shkollës së mesme profesionale "Ndre Mjeda", Bushat, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesëpadi me objekt: "Konstatimin e

pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës. Pagimin e dëmshpërblimeve përkatëse për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës".

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 200, datë 2.4.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3880, datë 22.10.2014, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 2.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër".*

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2016-710, datë 24.3.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyen se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit 49.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

II

5. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

5.1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë bërë cilësimin e saktë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, duke u bazuar në të dhëna të kontestuara dhe që nuk i janë njoftuar asnjëherë paditëses. Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë provat e paraqitura nga pala paditëse.

5.2. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka njoftuar palën paditëse (kërkuesen) në lidhje me gjykimin e datës 22.10.2014.

5.3. Është shkelur parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë në gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit nuk ka njoftuar kërkuesen për datën dhe orën e gjykimit.

5.4. Është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (ligji nr. 49/2012), parashikon se çështja në Gjykatë të Lartë shqyrtohet brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit. Rekursi është paraqitur në datën 14.11.2014, ndërsa Gjykata e Lartë është shprehur me vendim në datën 24.3.2016.

6. *Subjekti i interesuar, shkolla së mesme profesionale "Ndre Mjeda", Bushat,* pretendon se ka qenë e detyruar të suprimojë pozicionin e sekretares, pasi kërkuesja nuk mund të kryejë njëherësh edhe pozicionin e nëpunësit zbatues, për shkak të arsimimit të saj (të mesëm). Për rrjedhojë, në bazë të neneve 143 dhe 144 të Kodit të Punës, kërkueses i është njoftuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës, pasi detyrën në fjalë drejtoria ia ka ngarkuar ta kryejë nëpunësi zbatues.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* të kërkueses, në jurisprudencë konstante, Gjykata Kushtetuese ka theksuar faktin se ajo ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/1/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme

nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se argumentet e kërkueses në mbështetje të parregullsive në dy shkallët e para të gjykimit, për cilësimin jo të saktë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë të bëjnë me çështje të marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Nisur nga natyra ligjore e këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet *rationae materiae* për këto pretendime.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit

10. Sipas kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka njoftuar palën paditëse (kërkuesen) për gjykimin e datës 22.10.2014. Gjithashtu, ajo pretendon se është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve, pasi Gjykata e Lartë e shqyrtoi çështjen në mungesë të palëve, pa i njoftuar për datën dhe orën e gjykimit.

11. Bazuar në parimin *jura novit curia,* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 29, datë 30.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të pretendimeve të kërkueses, ato duhet të trajtohen në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

12. Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2016; nr. 28, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2016; nr. 67, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se në aspektin kushtetues dhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm brenda hapësirës së juridiksionit të tyre dhe në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të zbatojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, nga vendimet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se Gjykata e Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 2.4.2014,

të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Pas dhënies së vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkuesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se në arsyetimin e tij Kolegji Administrativ shprehet: *"kundër vendimit nr. 3880, datë 22.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs pala e paditur, shkolla e mesme "Ndre Mjeda", Bushat"*. Gjithashtu, edhe në dispozitivin e vendimit, Kolegji Administrativ shprehet për *"mospanimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur shkolla e mesme "Ndre Mjeda", Bushat"*. Gjykata vëren se në asnjë pjesë të vendimit të Kolegjit Administrativ nuk përmendet fakti i ushtrimit të rekursit nga kërkuesja. Për sa më sipër, duke u bazuar në përmbajtjen e vendimit të Kolegjit Administrativ, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkueses të paraqitura në rekurs nuk janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

16. Bazuar në këto konstatime, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke mos shqyrtuar rekursin e kërkueses në themel dhe në tërësi, ka ndikuar në cenimin e së drejtës së aksesit substancial të saj. Në këtë këndvështrim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara.

C. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesja pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku ai është depozituar.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se duhet të merret në analizë secili prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

21. Lidhur me periudhën e *kohës që duhet marrë në konsideratë,* nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 11.5.2015 dhe gjykimi është bërë në datën 24.3.2016, pra rreth 10 muaj pas regjistrimit, ndonëse neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin prej 90 ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo Gjykatë.

ii. Kompleksiteti i çështjes

22. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme

(shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

23. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i së cilës parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Objekti i saj lidhet me vlerësimin e dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe i kërkueses është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkueses

24. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

25. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit: "*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme"*, dhe në nenin 171/a të KPC-së, sipas të cilit: "G*jykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj"* (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka konstatuar se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin që ka shoqëruar ligjin nr. 49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është mbrojtja efektive e të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, ka vërejtur se në relacionin e ligjit të lartpërmendur lexohet se afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim) (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga sa më lart, Gjykata ka çmuar se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se justifikimi në çështje të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në

shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2016-710, datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha

VENDIM
Nr. 49, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 2.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 14 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pjetër Babaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 51, datë 28.4.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2016-656, datë 21.4.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 38, datë 6.3.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur: "*Deklarimin fajtor të të pandehurit Pjetër Lazër Babaj për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të armëve dhe municionit luftarak", parashikuar nga neni 278/a/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Pjetër Lazër Babaj për kryerjen e veprës penale të*

"Trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive," parashikuar nga neni 282/a/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, për bashkimin e dënimeve, dënimin e të pandehurit Pjetër Lazër Babaj me një dënim të vetëm prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së, përfundimisht i pandehuri Pjetër Lazër Babaj dënohet me 8 (tetë) vjet burgim".

2. Me vendimin nr. 51, datë 28.4.2015, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 38, datë 6.3.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në këtë mënyrë: Deklarimin fajtor të të pandehurit Pjetër Lazër Babaj për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", kryer në sasi të mëdha dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 278/6 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së, ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri Pjetër Babaj me 8(tetë) vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit nr. 38, datë 6.3.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në pjesët e tjera të tij*". Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs mbrojtësi i kërkuesit dhe Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda.

3. Me vendimin nr. 00-2016-656, datë 21.4.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, me arsyetimin se nuk përmbajnë shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

II

4. ***Kërkuesi Pjetër Babaj*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

4.1. *Është cenuar neni 29 i Kushtetutës*. Gjykata e Apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit, pasi, nga njëra anë, me të drejtë ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës, kurse, nga ana tjetër, në lidhje me masën e dënimit, e ka dënuar kërkuesin përsëri me 12 vjet burgim. Për rrjedhojë, edhe pse e vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuesit, ajo e ka rënduar pozitën e tij.

4.2. Kërkuesi është deklaruar fajtor në bazë të nenit 278/6 të Kodit Penal (KP), një ligj që nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Ndryshimet në këtë dispozitë janë bërë në vitin 2014, me ligjin nr. 98/2014, ku paragrafi i pestë është ndryshuar në gjashtë, si dhe është ndryshuar edhe minimumi i masës së dënimit për këtë vepër. Gjykata e Apelit nuk ka pasur parasysh nenin 3 të KP-së sipas të cilit zbatohet ligji, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Vepra penale nga kërkuesi është kryer në datat 6.2.2014 dhe 10.2.2014, kohë në të cilën ka qenë në fuqi ligji nr. 144/2013, sipas të cilit vepra penale e parashikuar në nenin 278/4 dënohej me burgim nga 7 deri në 15 vjet. Kërkuesi duhej të dënohej në bazë të paragrafit 4 të nenit 278, që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së saj, por gjykata e ka dënuar në bazë të paragrafit 6 të kësaj dispozite.

4.3. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos pasur parasysh shkaqet ligjore të ngritura në rekurs, si edhe nuk ka zbatuar vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar edhe pikat 5 dhe 6 të nenit 278 të KP-së.

5. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar këto argumente para Gjykatës:

5.1. Pretendimet e ngritura nga kërkuesi lidhur me aplikimin e dispozitës materiale për dënimin e tij, nën optikën e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit favorizues, që në thelb ka cenuar procesin e rregullt ligjor, janë të bazuara. Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

5.2. I gjykuari duhej të ishte deklaruar fajtor sipas pikës 5 të nenit 278 të KP-së, sipas ligjit 144/2013 të ndryshuar. Cilësimi juridik duhej të bëhej nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për sa kohë që çështja ishte në gjykim në bazë të rekursit të të gjykuarit.

5.3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të kishte marrë në konsideratë ndryshimet ligjore në KP përderisa e ka shqyrtuar çështjen pas vendimit nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae,* pasi pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

B. Për pretendimin e cenimit të nenit 29 të Kushtetutës

7. Sipas kërkuesit, Gjykata e Apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit, pasi, nga njëra anë, me të drejtë ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës, por, nga ana tjetër, në lidhje me masën e dënimit, e ka dënuar kërkuesin përsëri me 12 vjet burgim. Për rrjedhojë, edhe pse e vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuesit, ajo e ka rënduar pozitën e tij. Po sipas kërkuesit, ai është deklaruar fajtor në bazë të nenit 278/6 të KP-së, një ligj që nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Ndryshimet në këtë dispozitë janë bërë në vitin 2014, me ligjin nr. 98/2014, ku paragrafi i pestë është ndryshuar në gjashtë, si dhe është ndryshuar edhe minimumi i masës së dënimit për këtë vepër. Gjykata e Apelit nuk ka pasur parasysh nenin 3 të KP-së, sipas të cilit zbatohet ligji penal më i favorshëm. Edhe pse kërkuesi duhej të dënohej në bazë të paragrafit 4 të nenit 278, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është dënuar në bazë të paragrafit 6 të kësaj dispozite.

8. Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

9. Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen. Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata konstaton se nga aktet bashkëlidhur kërkesës, procedimi penal në ngarkim të kërkuesit është regjistruar në vitin 2004, i cili është akuzuar dhe dërguar për gjykim për veprën penale "Trafikimi i armëve dhe municionit luftarak", parashikuar nga neni 278/a/1 i KP-së. Në përfundim të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi është dënuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i armëve dhe municionit luftarak", parashikuar nga neni 278/a/1 i KP-së dhe "Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive", parashikuar nga neni 282/a/1 i KP-së. Gjykata e Apelit, në ndryshim nga sa më sipër, ka vlerësuar

se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprave penale të parashikuara nga paragrafi i tretë dhe paragrafi i parë i nenit 278 të KP-së. Po ashtu, kjo Gjykatë ka arsyetuar se duke konsumuar veprën penale "më shumë se një herë" dhe "në sasi të mëdha", veprimtaria e tij kriminale duhet të kualifikohej sipas paragrafit të fundit të nenit 278 i KP-së (faqe 26 e vendimit). Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit, në lidhje me masën e dënimit, ka vlerësuar se merr parasysh marzhin e masës së dënimit sipas ligjit nr. 144/2013 dhe se nuk mund të caktohet një masë më e rëndë dënimi për kërkuesin, për sa kohë që gjykimi është vënë në lëvizje në bazë të ankimit të tij. Në përfundim të gjykimit, kjo Gjykatë e ka dënuar kërkuesin me 12 vjet burgim, dhe në zbatim të nenit 406 të KPP-së, përfundimisht e ka dënuar me 8 vjet burgim.

11. Gjykata vlerëson se duke krahasuar parashikimet e dispozitave të KP-së rezulton se neni 278 është ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ku pas paragrafit të tretë është shtuar një paragraf me këtë përmbajtje: "Kur vepra kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet". Kurse ndryshimet e tjera që i janë bërë kësaj dispozite janë ato me ligjin nr. 144/2013 e në vijim. Për rrjedhojë, rezulton se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e ka dënuar kërkuesin në përputhje me përmbajtjen e dispozitave penale në fuqi në kohën e gjykimit të tij, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se nuk ka cenim të parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues. Për sa u takon pretendimeve në lidhje me kualifikimin e veprës penale apo masën e dënimit, ky është një aspekt që ka të bëjë me zbatimin e ligjit material penal dhe me vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatës që zgjidh çështjen konkrete dhe nuk mund të jenë objekt i kontrollit të kësaj Gjykate.

C. Për pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

12. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos pasur parasysh shkaqet ligjore të ngritura në rekurs. Po ashtu, ajo Gjykatë nuk ka zbatuar vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar pikat 5 dhe 6 të nenit 278 të KP-së.

13. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe vlerësojë në dhomë këshillimi nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Neni 432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 433 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga Kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Siç u parashtrua dhe u analizua më sipër, në rastin konkret kërkuesi është dënuar sipas një dispozite penale që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Pavarësisht se Gjykata e Apelit në dispozitivin e vendimit i referohet paragrafit 6 të nenit 278 të KP-së, siç arsyeton edhe vetë ajo në vendim, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit i është përmbajtur ligjit penal në kohën e kryerjes së veprës. Gjykata vlerëson se për sa i takon pretendimit për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vlerëson të ndalet për të analizuar nëse Kolegji Penal duhet të kishte marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të ligjit penal favorizues dhe fuqisë prapavepruese të tij.

15. Në rastin konkret, kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh se dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes në këtë gjykatë.

16. Gjykata vëren se ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ajo, me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, ka shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 656, datë 21.4.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit Pjetër Babaj. Pas vendimit të Gjykatës

Kushtetuese, me ligjin nr. 82/2016 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", neni 278 i KP-së është riformuluar, duke ndryshuar masat e dënimit. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 11.8.2016.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata thekson se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi,* eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese *(shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009, nr. 21 datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*

18. Gjykata vlerëson se sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lex retro agit in mitius* ose *lex mitior retro agit).* Ky parim i rëndësishëm kushtetues përmendet shprehimisht edhe në nenin 15/1 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së për të Drejtat Politike e Civile, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 4.1.1992.

19. Po ashtu, Gjykata gjatë jurisprudencës së saj është shprehur: "*Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se në momentin e shqyrtimit të çështjes (datë 24.4.2013) në Gjykatën e Lartë, ligji nr. 107/2012 "Për dhënie amnistie" kishte hyrë në fuqi (28.11.2012) dhe se vepra penale "Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë", për të cilën është dënuar kërkuesi, plotëson kriteret për përfitimin e amnistisë. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vendosur pushimin e çështjes për këtë vepër penale. Për pasojë, Gjykata çmon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.*

20. Duke marrë parasysh rrethanat më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues.

21. Gjykata vëren se, megjithëse është e njohur se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues.

22. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, duke zhvilluar në këtë mënyrë një proces të parregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-656, datë 21.4.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM
Nr. 50, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Mezan Hoxha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike (DAP), zyra përmbarimore “Strati Bailiff’s Service”

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj.

Pagesa e pagës nga ana e Ministrisë së Brendshme deri në ekzekutimin e aktit të emërimit.

Interpretimi i nenit 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42/1, 44, 49/1, 131/1/f, 134/1/i dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, Mezan Hoxha, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, zyrës përmbarimore “Strati Bailiff’s Service”, që kërkoi pranimin e kërkesës, DAP-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi rezulton se ka punuar në pozicionin inspektor në sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Brendshme, dhe për shkak të ristrukturimit të institucionit ka kaluar në listëpritje, pasi pozicioni i tij ka dalë i tepërt.

2. Më pas, struktura dhe organika e Ministrisë së Brendshme kanë ndryshuar dhe në Drejtorinë e Auditimit numri i inspektorëve nga 6 ka shkuar në 12. Me shkresën nr. 1661/2 të DAP-it, kjo e fundit vë në dijeni kërkuesin se kandidatura e tij është dërguar pranë Ministrisë së Brendshme për sistemimin e tij në pozicionin e mëparshëm.

3. Pas ankimit të bërë nga kërkuesi, KSHC-ja, me vendimin nr. 24, datë 16.2.2007, ka vendosur: *“Pranimin e ankesës. Shfuqizimin e aktit nr. 166/2, datë 14.12.2006 të DAP-it si të pabazuar në ligj. Detyrimin e DAP-it që të përfundojë procedurën e nisur me një akt emërimi. Kundër këtij vendimi të KSHC-së nuk rezulton të jetë bërë ankim”.*

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1356, datë 14.9.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas dispozitivit të vendimit nr. 24, datë 16.2.2007 të KSHC-së. Pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, DAP-i ka nxjerr urdhrin e emërimit me nr. 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, për kërkuesin.

5. Duke qenë se pas nxjerrjes së urdhrit të emërimit nga DAP-i, Ministria e Brendshme nuk ka kryer asnjë veprim për lidhjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare, kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë KSHC-së.

6. KSHC-ja, me vendimin nr. 28, datë 4.2.2008, ka vendosur: *“Paralajmërimin e institucionit të Ministrisë së Brendshme, duke i dhënë 2 muaj afat për të nxjerrë urdhrin e fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për ankuesin M. H., mbi bazën e aktit 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, të DAP, për emërimin e ankuesit M. H. nga lista e pritjes në pozicionin inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”.*

7. Pas ankimit të bërë nga Ministria e Brendshme, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 107, datë 22.9.2008, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak se pala paditëse nuk ishte paraqitur.

8. Pas rekursit të ushtruar nga Ministria e Brendshme, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-386 (42), datë 21.1.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 107, datë 22.9.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

9. Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 320, datë 23.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 4.2.2008, të KSHC-së.

10. Gjithashtu, nga dokumentet që shoqërojnë kërkesën, rezulton se, duke qenë se vendimi i KSHC-së nr. 28, datë 4.2.2008, nuk po zbatohej, KSHC-ja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: "Detyrimin e të padituri (Ministria e Brendshme) të nxjerrë urdhrin për fillimin e marrëdhënies financiare dhe pagimin e pagës që nga momenti i daljes së emërimit nga DAP-i nr. 1654/2, datë 23.10.2007, për shtetasin M. H.".

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6287, datë 13.7.2009, ka vendosur: *"Pranimin e padisë. Detyrimin e të padituri Ministria e Brendshme të nxjerrë urdhrin për fillimin e marrëdhënies financiare dhe pagimin e pagës që nga momenti i daljes së aktit të emërimit nga DAP-i, nr. 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, për shtetasin M. H.".*

12. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2329, datë 10.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 107, datë 7.2.2011, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 2329, datë 10.12.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë".* Në arsyetimin e tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë të përmbledhur shprehet: *"Konflikti i personit të tretë me palën e paditur është zgjidhur administrativisht dhe gjyqësish në proceset e mëparshme administrative. Për këtë është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit përkatës, si dhe akti i emërimit nga DAP-i. Në kushtet kur ministria nuk ka zbatuar urdhrin e nxjerrë nga DAP-i, vlerësojmë se nuk ka vend për ngritjen e padisë, por për ndjekjen nga personi i tretë të procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor".*

15. Mbi kërkesën e datës 13.2.2017 të kërkuesit, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 45, datë 2.03.2017, ka vendosur kthimin e kërkesës kërkuesit për plotësim.

16. Kërkuesi, në datën 27.3.2017, ka riparaqitur kërkesën e plotësuar drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

II

17. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar si vijon:

17.1. Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar. Me vendimin nr. 00-2014-38 (42), datë 21.1.2014, të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 28, datë 4.2.2008, të KSHC-së është kthyer për rishqyrtim, ndërsa vendimi nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, po të njëjtin vendim të KSHC-së e konsideron titull ekzekutiv.

17.2. Ministria e Brendshme duhet të paguajë pagën nga muaji nëntor 2013 deri në zbatim të aktit të emërimit nr. 1654/2, datë 23.10.2007, pasi deri në tetor 2013 është ekzekutuar nga zyra përmbarimore.

17.3. Interpretimin e nenit 8, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil".

17.4. Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

18. ***Subjekti i interesuar, zyra përmbarimore "Strati Bailiff's Service",*** pretendon se i ka kryer të gjitha veprimet procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, por Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka marrë asnjë masë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

19. ***Subjekti i interesuar, DAP-i,*** pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë

element të cenimit të të drejtave kushtetuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

19.1. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument për të evidentuar se cila e drejtë e tij është cenuar gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë.

19.2. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për interpretimin e nenit 8, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil", nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj gjykate.

19.3. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për detyrimin e Ministrisë së Brendshme që t'i paguajë pagën deri në ekzekutimin e aktit të emërimit, kërkuesi nuk legjitimohet për këtë pretendim, pasi detyrimi i organit publik për të kryer një veprim administrativ nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, por në gjykatat kompetente në shkallët më të ulëta të gjyqësorit.

20. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Punëve të Brendshme,*** pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

20.1. Në lidhje me parimin e cenimit të sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

20.2. Pas kërkesës së shoqërisë përmbarimore, Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar ekzekutimin e titullit ekzekutiv duke bërë pagesën në shtrirje kohore. Gjatë periudhës së ekzekutimit, Ministria ka qenë në pamundësi objektive për të zbatuar detyrimin e plotë për emërimin e kërkuesit në vendin e punës, pasi ai pozicion nuk ekziston më.

20.3. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për interpretimin e nenit 8, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil", nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj gjykate.

20.4. Kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtat e tij procedurale, duke mos shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për vendosjen e së drejtës së cenuar. Me revokimin e urdhrit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, të shoqërisë përmbarimore, nga ana e kërkuesit nuk ka kërkesë për ekzekutimin e vendimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

21. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e së drejtës kushtetuese të individit për një proces të rregullt, dhe Gjykata ndërhyn atëherë kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë këtë të drejtë. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata interpretimin e nenit 8, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil". Gjykata ka vlerësuar se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, në juridiksionin e saj hyjnë papajtueshmëria e ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën, kurse mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materia* në lidhje me këtë pretendim.

B. Për pretendimin për cenimin e sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar

24. Kërkuesi pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, sepse me

vendimin nr. 00-2014-38 (42), datë 21.1.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 28, datë 4.2.2008, të KSHC-së është kthyer për rishqyrtim, ndërsa vendimi nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, po i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, po të njëjtin vendim të KSHC-së e konsideron titull ekzekutiv.

25. Subjekti i interesuar, DAP-i, pretendon se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument për të evidentuar se cila e drejtë e tij është cenuar gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë.

26. Subjekti i interesuar, Ministria e Punëve të Brendshme, pretendon se pretendimet e kërkuesit për cenim të sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar janë të pabazuara.

27. Gjykata e ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Edhe në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin Gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se vendimi nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nuk e cenon kërkuesin në të drejtat e tij të fituara me vendimet gjyqësore të mëparshme. Në arsyetimin e tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë të përmbledhur shprehet: *"Konflikti i personit të tretë me palën e paditur është zgjidhur administrativisht dhe gjyqësish në proceset e mëparshme administrative. Për këtë është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit përkatës, si dhe akti i emërimit nga DAP-i. Në kushtet kur Ministria nuk ka zbatuar urdhrin e nxjerrë nga DAP-i, vlerësojmë se nuk ka vend për ngritjen e padisë, por për ndjekjen nga personi i tretë (kërkuesi) të procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor".* Për sa më sipër, Gjykata konstaton se me këtë vendim Gjykata e Lartë ka rikonfirmuar faktin e të drejtave të fituara të kërkuesit nga vendimet e mëparshme gjyqësore.

30. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

C. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë

31. Kërkuesi pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

32. Subjekti i interesuar, DAP-i, pretendon se kërkuesi nuk legjitimohet për këtë pretendim, pasi detyrimi i organit publik për të kryer një veprim administrativ nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, por në gjykatat kompetente në shkallët më të ulëta të gjyqësorit.

33. Subjekti i interesuar, Ministria e Punëve të Brendshme, pretendon se e ka përmbushur detyrimin duke bërë pagesën në shtrirje kohore, por gjatë periudhës së ekzekutimit, Ministria ka qenë në pamundësi objektive për të zbatuar detyrimin e plotë për emërimin e kërkuesit në vendin e punës, pasi ai pozicion nuk ekziston më. Gjithashtu, Ministria pretendon se kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtat e tij procedurale, duke mos shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për vendosjen e së drejtës së cenuar. Me revokimin e urdhrit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, të shoqërisë përmbarimore, nga ana e

kërkuesit nuk ka kërkesë për ekzekutimin e vendimit.

34. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre *(shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016; nr. 21, datë 7.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

36. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës *(shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr. 14, datë 30.3.2015; nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

37. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces *(shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

39. Duke e vlerësuar çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, në rastin konkret, rezulton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, datë 14.9.2007, deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë 10-vjeçare. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën rezulton se debitori ka kryer ekzekutimin e titullit ekzekutiv deri në datën 31.10.2013. Sa i përket detyrimit për kthimin në detyrë të kërkuesit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga pala debitore. Një periudhë e tillë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor konsiderohet si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë.

i. Kompleksiteti i çështjes

40. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në rastin konkret, çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e detyrimeve monetare përkatëse. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Interesi dhe sjellja e kërkuesit

42. Në rastin konkret, interesi i kërkuesit është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e tij për t'u

kthyer në punë dhe për t'u paguar. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit, që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

43. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën, rezulton se KSHC-ja me vendimin nr. 24. datë 16.2.2007, ka vendosur: *"Pranimin e ankesës. Shfuqizimin e aktit nr. 166/2, datë 14.12.2006, të DAP-it si të pabazuar në ligj. Detyrimin e DAP-it që të përfundojë procedurën e nisur me një akt emërimi. Kundër këtij vendimi të KSHC-së nuk rezulton të jetë bërë ankim"*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1356, 14.9.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas dispozitivit të vendimit nr. 24, datë 16.2.2007, të KSHC-së dhe pas kësaj DAP-i ka nxjerr urdhrin e emërimit me nr. 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, për kërkuesin. Duke qenë se pas nxjerrjes së urdhrit të emërimit nga DAP-i, Ministria e Brendshme nuk ka kryer asnjë veprim për lidhjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare, kërkuesi paraqiti kërkesë pranë KSHC-së. KSHC-ja me vendimin nr. 28, datë 4.2.2008, ka vendosur *"Paralajmërimin e institucionit të Ministrisë së Brendshme, duke i dhënë 2 muaj afat për të nxjerrë urdhrin e fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për ankuesin M. H, mbi bazën e aktit 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, të DAP-it, për emërimin e ankuesit M. H. nga lista e pritjes në pozicionin inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm"*. Pas ankimit të bërë nga Ministria e Brendshme, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 107, datë 22.9.2008, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak se pala paditëse nuk ishte paraqitur. Pas rekursit të ushtruar nga Ministria e Brendshme, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-386 (42), datë 21.1.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 107, datë 22.9.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 320, datë 23.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 4.2.2008, të KSHC-së. Gjithashtu, rezulton se, duke qenë se vendimi i KSHC-së nr. 28, datë 4.2.2008, nuk po zbatohej, KSHC-ja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: "Detyrimin e të paditurit (Ministria e Brendshme) të nxjerrë urdhrin për fillimin e marrëdhënies financiare dhe pagimin e pagës që nga momenti i daljes së emërimit nga DAP-i nr. 1654/2, datë 23.10.2007, për shtetasin M. H.". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6287, datë 13.7.2009, ka vendosur: *"Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurit, Ministria e Brendshme, që të nxjerrë urdhrin për fillimin e marrëdhënies financiare dhe pagimin e pagës që nga momenti i daljes së aktit të emërimit nga DAP-i, nr. 1654/2 Prot., datë 23.10.2007, për shtetasin M.H."*. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2329, datë 10.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 107, datë 7.2.2011, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1315 (223), datë 14.4.2015, ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. 6287, datë 13.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 2329, datë 10.12.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë"*. Në arsyetimin e tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë të përmbledhur shprehet: *"Konflikti i personit të tretë me palën e paditur është zgjidhur administrativisht dhe gjyqësish në proceset e mëparshme administrative. Për këtë është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit përkatës, si dhe akti i emërimit nga DAP-i. Në kushtet kur Ministria nuk ka zbatuar urdhrin e nxjerrë nga DAP-i, vlerësojmë se nuk ka vend për ngritjen e padisë, por për ndjekjen nga personi i tretë të procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor"*.

iii. Sjellja e autoriteteve

44. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin

e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë *(shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016; nr. 24, datë 22.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

45. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë, që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016; nr. 8, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

46. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se shoqëria përmbarimore "Strati Bailiff's Service" i është drejtuar debitorit me shkresat nr. 1029 Prot., datë 2.3.2011; nr. 1632 Prot., datë 12.4.2011; nr. 1968 Prot., datë 4.5.2011; nr. 2383 Prot., datë 6.6.2011, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të dhënë në favor të kërkuesit. Më pas, zyra përmbarimore, me shkresën nr. 2942 Prot., datë 13.7.2011, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit. Me shkresat nr. 3758 Prot., datë 14.9.2011; nr. 4349 Prot., datë 11.10.2011; nr. 306 Prot., datë 25.1.2012, zyra përmbarimore i drejtohet palës debitore për të vijuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të dhënë në favor të kërkuesit. Me shkresën nr. 2130 Prot., datë 11.4.2012, zyra përmbarimore i drejtohet Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit. Me shkresën nr. 3591 Prot., datë 30.5.2012, zyra përmbarimore i drejtohet përsëri debitorit për të vijuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe me shkresën nr. 6588 Prot., datë 14.9.2012, i drejtohet përsëri Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit. Zyra Përmbarimore, me shkresën nr. 4464 Prot., datë 17.4.2013, i drejtohet debitorit për të vazhduar ekzekutimin e vendimit gjyqësor për shumën e mbetur pa paguar dhe pas kësaj, me shkresën nr. 6895 Prot., datë 30.5.2013, i drejtohet përsëri Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit. Gjithashtu, me shkresat nr. 12608 Prot., datë 25.10.2013, dhe nr. 13999 Prot., datë 10.12.2013, zyra përmbarimore lajmëron debitorin për shlyerjen e detyrimit të mbetur. Me shkresën nr. 5055 Prot., datë 21.4.2014, zyra përmbarimore i drejtohet Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit. Më pas, zyra përmbarimore, me shkresat nr. 7015 Prot., datë 4.6.2014; nr. 7171 Prot., datë 9.6.2014; nr. 9129 Prot., datë 22.7.2014, i drejtohet palës debitore për vazhdimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe pagimin e shumës së mbetur pa paguar në favor të kërkuesit. Me vendimin e datës 18.9.2015, zyra përmbarimore vendos pushimin e ekzekutimit. Pas kërkesës me nr. 12991 Prot., datë 18.9.2015, bërë nga kërkuesi, zyra përmbarimore, me shkresat nr. 12992 Prot., datë 18.9.2015; nr. 14814 Prot., datë 28.10.2015; nr. 16726 Prot., datë 17.12.2015, i kërkon debitorit vazhdimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Më pas, me shkresën nr. 3260 Prot., datë 26.2.2016, zyra përmbarimore i drejtohet Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e debitorit.

47. Nga veprimet e mësipërme nuk krijohet bindja se është treguar vullnet i plotë për ekzekutimin e vendimit.

48. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim

gjyqësor i formës së prerë të mbetej i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016; nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, krijohet bindja se ky i fundit nuk i ka marrë të gjitha masat e duhura për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjykata konstaton se që prej vitit 2007, kur vendimi për njohjen e së drejtës kërkuesit ka marrë formë të prerë dhe deri në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj Gjykate, ndaj kërkuesit është zhvilluar një proces i parregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjykata vëren se mosekzekutimi për një kohë kaq të gjatë i vendimit gjyqësor të formës së prerë i sjell një dëm financiar të madh shtetit. Gjykata rithekson se debitori duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhej të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin e kërkuesit në punë, si një detyrim ligjor, i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv. E njëjta logjikë vlen edhe për pjesën tjetër të vendimit të formës së prerë në lidhje me detyrimet monetare.

50. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha

VENDIM
Nr. 51, datë 3.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 24 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Blerina Krantja

SUBJEKT I INTERESUAR: Banka e Shqipërisë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Shpërblimi i dëmit për shkak të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkueses, parashtrimet e subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës ka rezultuar se kërkuesja ka qenë e punësuar pranë subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, mbi bazën e një kontrate me afat të pacaktuar, në pozicionin e specialistes në sektorin e Politikave Sociale në Departamentin e Burimeve Njerëzore. Me urdhrin nr. 2242 Prot, datë 30.10.2013, të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë është urdhëruar zgjidhja e kontratës së punës.

2. Me pretendimin se zgjidhja e kontratës është bërë pa shkak dhe në mënyrë të menjëhershme, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar për dëmshpërblimin me pagën e 12 muajve për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës, me pagën e 3 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit, me pagën e 1 muaji për mosrespektimin e afatit të dorëzimit të detyrës, për të paguar pagën e 1 muaji si shpërblim për festat e fundvitit dhe pushimet vjetore të pakonsumuara, si dhe shpërblimin e dëmit jopasuror të shkaktuar ndaj saj.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 369, datë 3.2.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, detyrimin e subjektit të interesuar për të paguar 2 paga për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe 8 paga për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës.

4. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1255, datë 8.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 369, datë 3.2.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë subjekti i interesuar ka paraqitur rekurs dhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Me vendimin nr. 170, datë 21.5.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

II

6. Kërkuesja Blerina Krantja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e tejzgjatjes së afatit të gjykimit të çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

7. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar se ajo si palë ndërgjyqëse ka interes që gjykimi përfundojë në një kohë të arsyeshme. Lidhur me çdo pretendim tjetër nuk ka qëndrime shtesë përveç atyre të shprehura në shkallët e tjera të gjykimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë të cilin individi mund ta përdorë për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 23.10.2007, "Gjonboçari kundër Shqipërisë", §.77, në të cilin është shprehur se sistemi juridik shqiptar nuk parashikon një mjet të veçantë juridik të cilin individi mund ta përdorë për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin "Marini kundër Shqipërisë", të datës 7.7.2008, §.154, si dhe në vendimin "Hamzaraj kundër Shqipërisë", të datës 3.2.2009, §.30. Në këtë kuptim, kërkuesja Blerina Krantja legjitimohet para Gjykatës Kushtetuese për paraqitjen e kërkesës me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor

si pasojë e tejzgjatjes së afatit të gjykimit të çështjes.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

9. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së saj gjyqësore brenda afateve ligjore, të cilat vetë ligji i ka parashikuar të jenë të shpejta e të arsyeshme.

10. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata thekson se pretendimet e kërkueses lidhur me tejzgjatjen e gjykimit i shqyrton nën dritën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkueses, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesen kjo tejzgjatje.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

12. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën nga viti 2014, kur dosja është regjistruar në Gjykatën e Lartë, e në vijim.

ii. Kompleksiteti i çështjes

13. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, konkretisht detyrimi i subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, për të dëmshpërblyer kërkuesen me pagën e 12 muajve për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës, me pagën e 3 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit, me pagën e 1 muaji për mosrespektimin e afatit të dorëzimit të detyrës, për të paguar pagën e 1 muaji si shpërblim për festat e fundvitit dhe pushimet vjetore të pakonsumuara, si dhe shpërblimin e dëmit jopasuror të shkaktuar ndaj saj.

15. Gjykimi i kësaj mosmarrëveshjeje parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe nga shqyrtimi i akteve të paraqitura çështja nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj. Në këto rrethana, vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe i kërkueses është me rëndësi.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkueses

16. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkueses është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

17. Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se në këndvështrim të respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor gjykatat kanë për detyrë të evitojnë çdo vonesë të panevojshme në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, kërkuesja ka pretenduar tejzgjatje të afatit të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2014 dhe vazhdon të jetë në gjykim. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 170, datë 21.5.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. B-10 akti, datë 25.4.2017, ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë për çështjen konkrete. Gjykata e Lartë, me

shkresën nr. 1678/1, datë 2.5.2017, ka sqaruar se çështja është shpallur për gjykim në datën 19.4.2017, por është shtyrë për një datë të afërt, duke mos përcaktuar datën dhe arsyen e shtyrjes.

19. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka një tejzgjatje afati prej 3 vjetësh në shqyrtimin e çështjes konkrete, e cila si një mosmarrëveshje pune hyn në atë kategori çështjesh të cilat Gjykata e Lartë duhet t'i shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar. Gjithashtu, procedura e përshpejtuar parashikohet të zbatohet dhe për çështjet për të cilat është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit.

20. Gjykata konstaton se çështja objekt shqyrtimi jo vetëm është një mosmarrëveshje pune, por me vendimin nr. 170, datë 21.5.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, si një mosmarrëveshje administrative, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen brenda afatit prej 90 ditësh nga paraqitja e rekursit.

21. Gjykata vlerëson se ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara, çka nënkupton si ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit *(shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Lidhur me pretendimin e kërkueses për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga tejzgjatja e afatit të shqyrtimit të çështjes, Gjykata, bazuar në qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese, vlerëson se pretendime të kësaj natyre i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet në kërkimin e saj.

23. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në çështjen në shqyrtim mosrespektimi i kritereve për shqyrtimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar dhe i afateve ligjore nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk konstatohen arsye objektive të cilat do të justifikojnë mosgjykimin brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses Blerina Krantja për cenimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë.
- Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"

Çmimi 280 lekë